



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



MARËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur më: 08/08/2017 ndërmjet:

- Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan, të cilën e përfaqëson Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor, tani e tutje si UKZ
- dhe
- Shoqatën e Verëtarëve të Kosovës "Enologjia", të cilën e përfaqëson Z. Ismet Haxhimurati, Kryetar, me seli në: Shtëpia e Verës, Bernjak, Rahovec, tani e tutje si "Enologjia".

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi profesional dhe organizativ për krijimin e mundësisë për dërgimin e verëtarëve të Kosovës në garat e 10-ta ndërkombëtare për verërat që prodhohen nga universitetet apo vendet e universiteteve partnere, që do mbahet më 16 shtator 2017, në Maribor, Slloveni.

Duke pasur parasysh faktin se Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Mariborit, një mundësi e tillë është krijuar që edhe verëtarët e Kosovës të mund të marrin pjesë në këtë garë ndërkombëtare mjaft të rëndësishme. Ky organizim do të bëhet nga Universiteti i Mariborit dhe Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan do të dërgojë përfaqësuesit e saj nga Kosova, të cilët prodhojnë verë të garojnë në këtë garë.

Duke pasur parasysh se kjo Marrëveshje ka implikacione financiare, Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan do të mbulojë vetëm shpenzimet që do të mund të krijoheshin për përfaqësuesin e saj nga po ky Universitet. Shpenzimet e tjera për përfaqësuesit e kompanive do të mbulohen nga kompanitë apo në ndonjë mënyrë tjetër që ata mund ta gjejnë.

Poashtu ky bashkëpunim do të shtrihet edhe në fusha të tjera me interes për të dy palët, si: organizimi i tryezave të përbashkëta debatuese, organizimi i konferencave të përbashkëta, si dhe bashkëpunime të tjera të cilat mund të ndërlidhen me tema që janë me interes për të dy palët.

Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

Fushëveprimi i bashkëpunimit:

I. Krijimi i mundësisë për marrje pjesë në gara ndërkombëtare

- a) Bashkëpunimi profesional dhe organizativ për krijimin e mundësisë për dërgimin e verëtarëve të Kosovës në garat e 10-ta ndërkombëtare për verërat që prodhohen nga universitetet apo vendet e universiteteve partnere.
- b) Universiteti “Kadri Zeka” do të ofrojë resurset e veta akademike dhe profesionale, për krijimin e mundësisë së dërgimit të verëtarëve të Kosovës në gara të ndryshme ndërkombëtare, si dhe në bashkëpunime të tjera në të ardhmen.

II. Bashkëpunimi në fusha të tjera

- a) UKZ, përveç bashkëpunimi të lartëcekur do të shtrijë bashkëpunimin edhe në fusha të tjera me interes për të dy palët.
- b) Ky bashkëpunim do të shtrihet edhe në organizimin e tryezave të rrumbullakta, debateve, konferencave me interes shoqëror, si dhe shumë bashkëpunime dhe organizime që mund të dalin në të ardhmen, e që mund të shihen me interes për të dy palët.

III. Zbatimi

- a) Të promovojnë bashkëpunimin akademik, profesional dhe kulturor ndërmjet dy institucioneve për zbatimin e këtij Bashkëpunimi;
- b) Të përcaktojnë dy persona kontaktues për aktivitetet individuale dhe grupore dhe të planifikojnë koordinimin e të gjitha aktiviteteve brenda institucioneve të tyre; dhe
- c) Të takohen në bazë periodike për të rishikuar dhe vlerësuar aktivitetet e kaluara dhe ato që mund të shihen me interes për tu organizuar në të ardhmen.

IV. Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë për ndryshimet dhe plotësimet e tij, si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve. Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si:

- a) Ndryshimet ose plotësimet e marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre.
- b) Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë organizim të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

V. Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo Marrëveshje lidhet me kohë të caktuar. Kohëzgjatja e zbatimit të bashkëpunimit do të përcaktohet në bazë të fondeve në dispozicion për të dy institucionet si dhe në bazë të asistencës financiare që mund të realizohet nga burimet e jashtme.

Përfundimi i kësaj marrëveshje mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

Kjo Marrëveshje mund të përfundoj njëanshëm nga njëra palë me paralajmërim prej së paku tre muajsh.

Marrëveshjet gojore për çështje të caktuara, gjithashtu nuk gjejnë mbështetje në këtë Marrëveshje dhe ato nuk do të merren parasysh.

VI. Ligji i aplikueshëm

Palët respektojnë dhe zbatojnë ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, rregullat dhe kërkesat tjera të aplikueshme të autoriteteve përkatëse shtetërore.

VII. Mospajtimet

Të gjitha mospajtimet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.

VIII. Hyrja në fuqi

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Bashkëpunimi nënshkruhet në dy kopje, për secilën palë nga një.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë: 08/08/2017

Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan



Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor

Shoqata e Verëtarëve të
Kosovës "Enologjia"

Ismet Haxhimurati, Kryetar